

VENDIM
Nr.559, datë 11.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.413, DATË 26.5.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS, SI DHE TË
STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË AUTORITETIT
TË AVIACIONIT CIVIL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 16 të ligjit nr.10 233, datë 11.7.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil” dhe ligjit nr. 10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.413, datë 26. 5.2010, të bëhen këto ndryshime:

1. Lidhja nr. 3, që përmendet në pikën 3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.3, është sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. Shtesa për kualifikim, kolona 3, e lidhjes nr.3, është 0.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha